

RAPORT I NDËRMJETËM 2¹ 1–14 Janar 2007

I. PËRMBLEDHJE

- Më 12 Janar, forcat politike dhe koalicionet arritën një marrëveshje në një tryezë të rrumbullakët të iniciuar dhe drejtuar nga Presidenti Alfred Moisiu. Kjo lejoi rifillimin e procesit zgjedhor.
- Pas marrëveshjes, Kuvendi, më 13 janar, amendoi Kushtetutën, Kodin Zgjedhor, si edhe Ligjin për Radion dhe Televizionin Publik dhe Privat. Më 14 janar, Presidenti përcaktoi 18 shkurtin si datën e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.
- Sipas amendamenteve, mandati i të zgjedhurve lokalë është shtyrë nga tre në katër vjet. Përfaqësimi i partive në komisionet zgjedhore të të gjitha niveleve, përfshirë edhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), është rritur. Përveç kësaj, janë trajtuar një sërë rekomandimesh të mëparshme të OSBE/ODIHR-it, sidomos mbi dispozita që kanë lidhje me numërimin e votave, si dhe me procesin e ankimeve dhe apelineve.
- Një amendament tjetër i Kodit Zgjedhor krijon mundësi për ndryshimin e renditjes së kandidatëve në listën e kandidatëve pas regjistrimit të listave nga komisionet zgjedhore përkatëse, si edhe pas votimit. Megjithëse rregullat për një rirenditje të tillë mund të bëhen publike në kohën e regjistrimit, kjo gjë shkakton shqetësim përse i përket përputhshmërisë së dispozitave të tilla ligjore me parimet demokratike, pasi ajo zvogëlon transparencën për zgjedhësit.
- Sipas dispozitave kalimtare për këto zgjedhje, afati për formimin e Komisioneve Zgjedhore të Qeverisjes Vendore është 20 janari. Kjo datë përbën gjithashtu edhe afatin e regjistrimit të partive dhe koalicioneve në KQZ. Emrat e kandidatëve u duhen dorëzuar KZQV-ve brenda datës 23 janar.
- Megjithë ngjeshjen e afateve ligjore për zgjedhjet e ardhshme, mbetet kohë e mjaftueshme për një përgatitje të mjaftueshme të zgjedhjeve, në qoftë se të gjithë aktorët shfaqin vullnetin e duhur politik, veçanërisht partitë politike, roli dhe përgjegjësitë e të cilave në procesin zgjedhor mbeten vendimtare.
- Rregullat kalimtare për përdorimin dhe administrimin e certifikatave të lindjes parashikojnë procedura të nderlikuara dhe të rënduara, të cilat mund të përbëjnë një sfidë për zyrat e gjendjes civile (ZGjC), komisionet zgjedhore dhe zgjedhësit.
- Meqënëse Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGjC) në Ministrinë e Brendshme e ka marrë pjesën më të madhe të listave të zgjedhësve, pritjet që procesi i

¹ Ky raport është i përkthyer në gjuhën shqipe. Sidoqoftë, varianti në gjuhën angleze mbetet i vetmi dokument zyrtar.

korrigjimeve dhe prodhimit të listave përfundimtare të zgjedhësve të kryhet brenda afateve të ngjeshura ligjore.

- KQZ-ja, puna e së cilës është penguar rëndë nga bllokimi i kaluar, rifilloi përgatitjet për zgjedhjet një ditë pas arritjes së marrëveshjes.
- Rezultatet paraprake të monitorimit të medias tregojnë se si media private, ashtu edhe ajo publike bëjnë një pasqyrim të zgjeruar të çështjeve që lidhen me zgjedhjet, ku transmetuesi publik TVSH tregon një trajtim preferencial të Partisë Demokratike në lajmet e tij kryesore.

II. KLIMA POLITIKE

Pas disa javësh bashkëbisedimesh të vazhdueshme, pa rezultat dhe nganjëherë me përplasje, të cilat përfshinë paraqitjen e propozimeve e kundërpropozimeve të ndryshme, si edhe raunde të ndryshme negociatash, udhëheqësit e partive arritën më në fund një marrëveshje mbi çështjen e diskutueshme të identifikimit të zgjedhësve. Marrëveshja u arrit në orët e fundit të 12 janarit, brenda kuadrit të një tryeze të rrumbullakët të iniciuar dhe drejtuar nga Presidenti i Republikës, z. Alfred Moisiu, në një mënyrë shumë konstruktive.

Kjo marrëveshje politike i dha mundësi Kuvendit që të miratonte disa amendamente në Kushtetutë, Kodin Zgjedhor, si dhe Ligjin për Radion dhe Televizionin Publik dhe Privat në një seancë të jashtëzakonshme më 13 janar (për hollësi të mëtejshme, shiko Pjesën III, Amendamentet e Kuadrit Ligjor). Këto mendamente, të cilat hynë në fuqi më 13 janar, bënë të zbatueshme marrëveshjet e 30 gushtit dhe 30 dhjetorit 2006 midis shumicës qeverisëse dhe opozitës, si edhe përfshinë termat e marrëveshjes së tryezës së rrumbullakët të arritur një ditë më parë në Kodin Zgjedhor. Kodi Zgjedhor u votua unanimitisht; aktet e tjera nga një shumicë dërrmuese. Pas miratimit të amendamenteve nga Kuvendi, Presidenti Moisiu nxori një dekret të ri më 14 janar, duke përcaktuar 18 shkurtin si datën për mbajtjen e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Para arritjes së kësaj marrëveshjeje, mospajtimet përsa i përket çështjes kyçe të certifikatave të lindjes si një formë e identifikimit të zgjedhësve vazhdonin të ndanin koalicionin qeverisës dhe opozitën dhe kërcënonin të vononin mbajtjen e zgjedhjeve pas afatit kushtetues të 20 shkurtit. Më 6 janar, Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) kishte deklaruar se KQZ-ja nuk do të ishte teknikisht në gjendje t'i zhvillonte zgjedhjet më 20 janar, data e dekretuar fillimisht nga Presidenti.

Diskutimet politike për zbatimin e marrëveshjes së 30 dhjetorit u rihapën më 3–4 janar në kuadrin e Komisionit Parlamentar të Ligjeve. Megjithëse të dyja palët qenë në gjendje të gjenin zgjidhje për disa çështje ende të pazgjidhura, ato mbetën të ndara përsa i përket çështjes së certifikatave të lindjes si dokumente identifikimi, dhe vecanërisht, përsa u përket dokumenteve shtesë të identifikimit që do të kërkoheshin për të mbështetur ato certifikata që janë lëshuar para zbatimit të një vendimi të Ministrisë së Brendshme të datës 1 nëntor 2006, i cili kërkonte regjistrimin e certifikatave në regjistra të posaçëm (në vijim do të quhen 'certifikata të vjetra').

Ndërsa partitë e shumicës ishin për një listë më të gjatë të dokumenteve të tillë mbështetës, opozita donte t'i kufizonte ato vetëm në pasaportat e vjetra dhe letërnjoftimet e vjetra. Shumica dilte me argumentin se kjo do do t'u mohonte në mënyrë të padrejtë të drejtën e votës shumë

zgjedhësve, por opozita mbrojti qëndrimin se ishte e nevojshme të kontrollohej përdorimi i mundshëm me qëllim manipulimi i votave. Mbledhja e komisionit u ndërpre më 4 janar pa ndonjë kompromis dhe pa përcaktuar ndonjë datë për mbledhje të tjera.

Gjithashtu, më 4 janar, një deklaratë e përbashkët u lëshua nga komuniteti diplomatik në Tiranë, përfshirë Prezencën e OSBE-së në Shqipëri, Këshillin e Europës (KE), Presidencën e BE-së, Delegacionin e Komisionit European, Ambasadën Amerikane, nëpërmjet së cilës ata shprehën shqetësimin e tyre të thellë mbi mungesën e progresit të bërë në përgatitjet për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore dhe u bënë thirrje të dyja palëve që t'i zgjidhnin të gjitha çështjet e pazgjidhura e të zbatonin, me mirëbesim, marrëveshjen e 30 dhjetorit. Kjo deklaratë e përbashkët u shoqërua nga një deklaratë e z. Javier Solana, Përfaqësues i Lartë i BE-së për Politikën e Jashtme dhe Sigurinë, i cili theksoi se mosgarantimi i zgjedhjeve demokratike do të rrezikonte cënimin e përparimit të Shqipërisë drejt integritimit evropian.

Në kuadrin e kësaj krize, më 8 janar, Presidenti Moisiu u bëri thirrje të gjitha partive parlamentare të mblidheshin nën kujdesin e tij e të gjenin një zgjidhje të përbashkët në një tryezë të rumbullakët presidenciale, e planifikuar për datën 9 janar. Kjo lëvizje, megjithëse e refuzur fillimisht nga Kryeministri dhe Udhëheqësi i Partisë Demokratike (PD), Dr. Sali Berisha, u mirëprit më në fund nga të dyja palët. Komuniteti ndërkombëtar, përmes deklaratave të Sekretarëve të Përgjithshëm të OSBE-së dhe KE-së, theksuan gjithashtu rëndësinë e nismës presidenciale si një instrument i mundshëm për krijimin e konsensusit. Kryetari i Radhës i OSBE-së, Ministri i Jashtëm i Spanjës, Miguel Angel Moratinos, nisi në Tiranë një të dërguar personal, Ambasadorin Jose Pons, për të ndihmur në gjetjen e një kompromisi, pas një kërkesë për ndihmë të partive politike.

Udhëheqës të të dyja palëve u mblodhën më 9 janar dhe filluan negociatat duke u përqendruar në një projekt-marrëveshje të paraqitur nga Presidenti. Pas tre raundesh, bisedimet fillestare nuk dhanë rezultate konkrete, pasi që të dyja palët propozuan zgjidhje të ndryshme për çështjen e certifikatave të lindjes. Pas kësaj, shumica dha një konferencë për shtyp duke deklaruar se ajo e mbështeste plotësisht projekt-marrëveshjen e paraqitur nga Presidenti, duke nënshkruar një deklaratë për këtë e duke i bërë thirrje opozitës që të bënte të njëjtën gjë. Opozita, në të kundërt, nxori një kundërpropozim, i cili e largonte atë nga pozicioni i saj i ri-regjistrimit të të gjitha 'certifikatave të vjetra', duke propozuar që të gjitha kopjet e dokumenteve mbështetëse të identifikimit të noterizoheshin paraprakisht. Ky kundërpropozim nuk u pranua nga shumica.

Takimi tjetër i tryezës u zhvillua në mbrëmjen e 10 janarit dhe vazhdoi deri në orën 8:30 të mëngjesit pa arritur ndonjë kompromis. Gjithashtu, më 10 janar, NATO-ja, nëpërmjet një deklarate, u bëri thirrje politikanëve shqiptarë të gjenin një zgjedhje për krizën zgjedhore dhe theksoi se mbajtja e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme ishte thelbësore për aspiratat e vendit për t'u bashkur me aleancën.

Pas një mungese të dallueshme progresi në negociatë, Kryeministri Berisha dhe paraardhësi i tij, ish-kryetari i Partisë Socialiste (PS), z. Fatos Nano, bënë një deklaratë të përbashkët publike më 11 Janar, duke u bërë thirrje të dyja palëve që të punonin së bashku për të gjetur një zgjidhje për krizën aktuale në bazë të marrëveshjes se 30 dhjetorit 2006 dhe Vendimit të KQZ-së Nr.1076, datë 1 korrik 2005. Ata theksuan gjithashtu se qëllimet e integritetit të mëtejshëm nuk duhet t'u nënshtrohen interesave politike personale. Disa orë më vonë atë mbrëmje, drejtuesit e PS-së dhe Lëvizjes Socialiste për Integritim (LSI) dolën veçmas në konferenca për shtyp, në të cilat ata ritheksuan mbështetjen e tyre për nismën e Presidentit për gjetjen e një kompromisi dhe i bënë thirrje Kryeministrit që të merrte pjesë në bisedime. Drejtuesi i PS-së dhe Kryetari i Bashkisë së

Tiranës, z. Edi Rama, theksoi se regjistrimi i certifikatave ishte një rekomandim që vinte nga komuniteti ndërkombëtar dhe se propozimi i tyre kishte për qëllim zbatimin e këtij rekomandimi.

Më 12 janar, Presidenti u takua veçmas me të dyja palët gjatë gjithë ditës para se të mblidhte tryezën në mbrëmje për bisedimet përfundimtare. Pas këtyre bisedimeve, drejtuesit e të gjitha partive parlamentare (përveç PD-së, e cila përfaqësohej nga Nënkryetari z. Bamir Topi) nëshkruan marrëveshjen në praninë e Presidentit dhe të medias. Kryetari i Radhës i OSBE-së bëri një deklaratë publike më 13 janar, duke mirëpritur dhe përshëndetur përpjekjet e Presidentit për ndërmjetësimin e procesit. Gjithashtu, ai i inkurajoi të dyja palët që ta ruanin frymën e konsensusit dhe respektimit të shtetit ligjor dhe institucioneve demokratike.

III. AMENDAMENTET E KUADRIT LIGJOR

Rrethanat e veçanta për zgjedhjet e ardhshme dhe shtyrja e tyre në një kohë shumë të vonë kanë bërë të nevojshme ngjeshjen e të gjitha afateve ligjore për përgatitjet dhe procedurat zgjedhore. Megjithatë, mbetet kohë e mjaftueshme për përgatitjen e duhur për zgjedhje, nëse ekziston vullneti i partive politike, roli dhe përgjegjësitë e të cilave në procesin zgjedhor mbeten vendimtare.

Kuvendi ndryshoi Nenin 109 të Kushtetutës, duke shtyrë mandatin e kryetarëve të bashkive dhe komunave dhe këshillave të tyre nga tre në katër vjet. Rregulli i ri është i vlefshëm duke filluar nga zgjedhjet e ardhshme për organet e qeverisjes vendore. Duke parë se mandati tre-vjeçar ishte shumë më i shkurtër sesa në shumicën e vendeve europiane, Rekomandimet e Përbashkëta të Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës dhe OSBE-ODIHR-it të vitit 2004 kishin rekomanduar që të rishikohej mandati tre-vjeçar.

Dispozitat e Kushtetutës dhe të Kodit Zgjedhor mbi përbërjen e KQZ-së u ndryshuan për të rritur numrin e anëtarëve të KQZ-së nga shtatë në nëntë, ku dy anëtarët e rinj do të caktohen nga Kuvendi.

Numri i anëtarëve të Komisioneve Zgjedhore për Qeverisjen Vendore (KZQV), Komisioneve të Qendrave të Votimit (KQV) dhe Ekipeve të Numërimit është rritur nga shtatë në trembëdhjetë, duke u dhënë mundësi përfaqësimi gjashtë partive më të mëdha parlamentare në secilën anë të spektrit.² Ky amendament zvogëlon kontrollin e dy partive politike kryesore mbi komisionet e nivelit të mesëm dhe të ulët dhe trajton kështu pjesërisht një rekomandim të mëparshëm të OSBE/ODIHR-it. Megjithatë, kjo mund të përbëjë një sfidë për disa prej partive politike në gjetjen e një numri të mjaftueshëm anëtarësh për plotësimin e vendeve të tyre në KZQV dhe KQV. Ndërsa Kodi Zgjedhor vazhdon të mbështetet vetëm te partitë politike për të administruar zgjedhjet, ky do të jetë një model efikas vetëm nëse partitë politike veprojnë në një mënyrë konstruktive. Megjithatë nuk ka një mekanizëm që do të lejonte plotësimin e vendeve vakante në mënyra të tjera në qoftë se partitë heqin dorë nga e drejta e tyre e emërimit ose nuk e ushtrojnë atë.

² Të njëjtat ndryshime janë bërë përsa i përket përbërjes së Komisioneve të Zonave Zgjedhore (KZZ) për zgjedhjet parlamentare. Meqënëse spektri i majtë në Kuvend aktualisht përbëhet nga pesë parti, PS-ja do të ketë të drejtë të emërojë anëtarët e komisioneve. Sipas këtij rregulli të ri, partitë që do ta kenë këtë të drejtë do të jenë: Partia Demokratike (PD), Partia Socialiste (PS), Partia Republikane (PR), Partia Demokratike e Re (PDR), Partia Demokristiane (PDK), Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut (PBDNj), Partia Agrare Ambientaliste (PAA), Lëvizja Socialiste për Integritim (LSI), Aleanca Demokratike (AD), Partia Social Demokratike (PSD) dhe Partia për Demokracia Sociale (PDS).

Amendamentet e sapomiratuara i kanë eliminuar të gjitha referencat ndaj regjistrit të përkohshëm të qytetarëve në Kodin Zgjedhor. Ky është një ndryshim i mirëpritur që pasqyron faktin se regjistri i përkohshëm ka pushuar praktikisht së ekzistuari. Ndërsa procedurat për përpilimin dhe verifikimin e listave të zgjedhësve mbeten përgjithësisht të pandryshuara, afatet përkatëse u janë përshtatur realiteteve të reja përmes një dispozite kalimtare që u përket vetëm zgjedhjeve të ardhshme.

Në përputhje me një rekomandim të Raportit Përfundimtar të OSBE/ODIHR-it të vitit 2005, afati për emërimin e ekipeve të numërimit ka ndryshuar nga dy orë para mbylljes së votimit deri në dy ditë para ditës së zgjedhjeve. Është pozitive që amendamenti parashikon një përjasje elastike ndaj përcaktimit të numrit të kërkuar të ekipeve të numërimit, në varësi të madhësisë së njësive të qeverisjes vendore (NjQV), dhe lejon që ekipet e numërimit të operojnë me turne. Të dy ndryshimet kanë qenë rekomanduar në raportin e mëparshëm të OSBE/ODIHR-it si mjete të mundshme për të garantuar që numërimi i votave të përfundojë në kohë. Në Tiranë, fletët e votimit do të numërohen në secilën prej 11 minibashkive. Në përpjekje për të rritur transparencën e procesit të numërimit, amendamentet parashikojnë mundësinë që KQZ-ja të vendosë për përdorimin e kamerave regjistruese dhe monitorëve (ekraneve) për shfaqjen e fletëve të votimit para vlerësimit të tyre.

Janë trajtuar një sërë rekomandimesh të OSBE/ODIHR-it në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore. Në veçanti, amendamentet e sapomiratuara parashikojnë unifikimin e një procedure për trajtimin e kërkesave për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve dhe ankesat në lidhje me to me afate të shkurtuara. Gjithashtu, është miratuar një përjasje më pak formale për vlerësimin e provave nga KQZ-ja, në përputhje me rekomandimet e Raportit Përfundimtar të OSBE/ODIHR-it të vitit 2005. Në lidhje me shqyrtimin e materialeve zgjedhore gjatë një hetimi administrativ, KQZ-së i është dhënë qartazi e drejta për të hapur kutitë e materialeve zgjedhore dhe/ose kutitë e fletëve të votimit nëse kjo gjë kërkohet gjatë hetimit.

Megjithatë, një aspekt i veçantë i amendamenteve ngre disa shqetësime. Amendamentet e nenit 87 të Kodit Zgjedhor i lejojnë subjektet zgjedhore që të emërojnë kandidatë (d.m.th. partitë ose koalicionet) të depozitojnë në KZQV një marrëveshje që specifikon formulën që do të aplikohet, pas votimit, për renditjen përfundimtare të kandidatëve në listat e tyre. Kjo është problematike në disa aspekte:

- Siç është vënë në dukje nga Rekomandimet e Përbashkëta të Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës dhe OSBE/ODIHR-it të vitit 2004: “Do të ishte në kundërshtim me angazhimet e OSBE-se dhe standardet ndërkombëtare po të lejohej një rirenditje ose një renditje “përfundimtare” e kandidateve pasi zgjedhësi ka votuar..”
- Një mundësi e tillë, që ekzistonte për zgjedhjet parlamentare, është kritikuar edhe në Raportin Përfundimtar të OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet parlamentare të vitit 2005, i cili theksonte se “mandatet duhet të shpërndahen në përputhje me pozicionin e kandidatit në listën zgjedhore, siç është përcaktuar para ditës së zgjedhjeve”.
- Në një nivel më praktik, kjo jo vetëm mund të përbëjë një sfidë për KZQV-të në zbatimin e formulave të zgjedhura nga partitë, veçanërisht në qoftë se ato janë të paqarta, jo të njëtrajtshme, apo në kundërshtim me njëra-tjetrën, por mundet gjithashtu të rrisë ndjeshëm numrin e ankesave për t'u gjykuar nga KQZ-ja dhe Kolegji Zgjedhor, pasi kandidatët mund të vendosin të kundërshtojnë shpërndarjen e vendeve nga KZQV-ja sipas formulës renditëse.

Mundësitë e krijuara nga ky amendament jo vetëm që mund të sfidojnë parimet demokratike, por ato mund të hapin mjaft çështje praktike dhe ligjore.

IV. ADMINISTRATA ZGJEDHORE

Për shkak të ngërcit politik aktivitetet e administratës zgjedhore ngecën plotësisht para marrëveshjes së 12 janarit dhe miratimit pas saj të amendamenteve.

Gjatë kësaj periudhe raportimi, KQZ-ja u përpoq t'i zhvillonte aktivitetet e saj në mënyrë kolegjiale dhe profesionale. Megjithatë, vendimet e vetme që asaj i duhej të merrte, lidheshin me emërimin e anëtarëve shtesë të KZQV-ve të emëruar nga PD-ja, Partia Republikane dhe Partia Demokratike e Re, si dhe përcaktimi i rrogave të anëtarëve të KZQV-ve.

KQZ-ja zhvilloi një mbledhje informuese, ku Zëvendësministri i Brendshëm bëri një prezantim të programit kompjuterik të përdorur nga DPGjC-ja dhe të gjitha ZGjC-të për hartimin e listave të zgjedhësve. Anëtarët e KQZ-së të emëruar nga opozita e konsideruan mbledhjen jo në përputhje me objektivat e KQZ-së dhe u larguan nga kjo mbledhje. Për pjesën tjetër të kësaj periudhe raportimi, KQZ-ja u mbledh vetëm një herë për të pranuar zyrtarisht një dhurim nga komuniteti ndërkombëtar, ndërkohë që anëtarët e saj ishin në pritje të një zgjidhjeje politike, e cila do të mundësonte rifillimin e aktiviteteve të tyre.

Pas shpalljes së datës së re të zgjedhjeve, KQZ-ja është përballur me afate të ngjeshura ligjore dhe nevojën për të zbatuar dispozitat e reja ligjore përmes vendimeve dhe udhëzimeve të KQZ-së. KQZ-ja ka shtatë ditë që nga hyrja në fuqi e amendamenteve për të formuar 384 KZQV, d.m.th. deri më 20 janar. Tani, ajo po përballet me detyrën e emërimit të anëtarëve të rinj të KZQV-ve, kërkimin e burimeve buxhetore shtesë për shpërblimin e tyre, si dhe me gjetjen e hapësirave të përshtatshme për akomodimin e KZQV-ve më të mëdha tashmë në numër. Afati shtatë-ditor vlen gjithashtu edhe për regjistrimin e subjekteve zgjedhore (partive politike dhe koalicioneve). Kandidatët për kryetarë bashkie apo komune dhe kandidatët për anëtarë këshillash kanë dhjetë ditë për të paraqitur në KZQV dokumentacionin e regjistrimit deri më 23 janar.

V. REGJISTRIMI I ZGJEDHËSVE

Para marrëveshjes së 12 janarit, 299 nga 384 NjQV i kishin dërguar listat paraprake të zgjedhësve në DPGjC. Kryetari i bashkisë së Vlorës, një nga qytetet kryesore, i dorëzoi listat e zgjedhësve të kësaj bashkie vetëm më 9 janar. Kjo vonesë e konsiderueshme, që e tejkaloi afatin fillestar të 22 dhjetorit, e pengoi kontrollimin në nivel vendi të listave për duplikata të mundshme nga DPGjC-ja.

DPGjC-ja shpresonte t'i merrte listat e munguara të zgjedhësve menjëherë pas miratimit të amendamenteve. Sipas dispozitës kalimtare në lidhje me afatet për hartimin e listave të zgjedhësve për zgjedhjet e ardhshme, DPGjC-ja do të jetë në gjendje të kontrollojë për duplikata të mundshme nga 21 janari deri më 6 shkurt. Megjithë afatet e ngjeshura, DPGjC-ja dhe ZGjC-të duhet të kenë kohë të mjaftueshme për të korrigjuar, shtypur dhe shpallur listat e zgjedhësve brenda afateve ligjore.

VI. CERTIFIKATAT E LINDJES

Pas marrëveshjes së 12 janarit, në Kodin Zgjedhor u fut një dispozitë kalimtare, e cila përcakton rregulla të veçanta për përdorimin dhe administrimin e certifikatave të lindjes në zgjedhjet e ardhshme për organet e qeverisjes vendore. Rregullat e reja parashikojnë procedura të ndërlikuara dhe të rënduara, të cilat mund të përbëjnë një sfidë të rëndësishme për ZGjC-të, KZQV-të dhe KQV-të, dhe ajo që është më e rëndësishmja, për zgjedhësit.

Sipas kësaj dispozite kalimtare, parashikohen modalitete të ndryshme për verifikimin e certifikatave të lindjes, në varësi të kohës së lëshimit të tyre:

- Certifikatat e lëshuara pasi regjistrimi i tyre të bëhet i detyrueshëm dhe deri një ditë para ditës së zgjedhjeve do të verifikohen nga KQV-të përkundrejt një kopjeje të vërtetuar nga regjistri i posaçëm që ZGjC-ja e ka marrë nëpërmjet KZQV-së.
- Certifikatat e lëshuara ditën para zgjedhjeve dhe në ditën e zgjedhjeve do të verifikohen përkundrejt një “procesverbal” të ZGjC-së, i cili regjistron numrat e serisë të të gjitha certifikatave që janë përcaktuar që më përpara për t’u lëshuar gjatë kësaj periudhe. Megjithëse në amendament përmenden certifikatat e lindjes të lëshuara për qëllime të ndryshme, nga formulimi i tij është e qartë se ZGjC-të presupozohen të caktojnë një numër të caktuar certifikatash për qëllime zgjedhore për çdo qendër votimi. Për çdo qendër votimi, numri i certifikatave të paplotësuara që i janë caktuar nuk mund të jetë më i lartë sesa numri i zgjedhësve të regjistruar. Formulimi i paqartë i kësaj dispozite mund të shkaktojë konfuzion ndër ZGjC-të dhe të çojë në një zbatim jo të njëtrajtshëm, në qoftë se nuk jepet një sqarim më i hollësishëm.
- Për të votuar me një certifikatë lindjeje të lëshuar para krijimit të regjistrimit të posaçëm, zgjedhësi duhet të paraqesë origjinalin dhe fotokopje të dy prej tetë dokumenteve të renditur si prova plotësuese të identitetit. Numrat e serive të këtyre certifikatave duhet të verifikohen përkundrejt një “procesverbal” të Ministrisë së Brendshme që përmban numrat e serive të të gjitha certifikatave të lindjes të paplotësuara që i janë shpërndarë secilës ZGjC. Certifikatat dhe fotokopjet do të mbahen nga KQV-të.

Dispozita kalimtare u jep të drejtën partive politike të marrin listat e regjistrave të institucioneve vërtetuese për verifikimin e mjeteve plotësuese të identifikimit. Megjithatë, zbatimi i kësaj dispozite duket sfidues në praktikë, duke pasur parasysh llojshmërinë dhe statusin e institucioneve të përfshira dhe afatin e shkurtër kohor.

Një rregull i ri është futur për zgjedhësit që kanë emigruar jashtë shtetit. Këta qytetarë mund të votojnë vetëm duke paraqitur një pasaportë të vlefshme, ose që i ka skaduar afati i përdorimit, si dhe kartën e identitetit të vendit ku jetojnë. Kjo kërkesë është në dukje diskrimuese ndaj këtij grupi zgjedhësish dhe nuk merr parasysh faktin që shumë vende nuk u lëshojnë rezidentëve të huaj karta të posaçme identiteti. Për më tepër, nuk është e qartë se si do të operojnë praktikisht grupet e emëruara nga KQZ-ja për identifikimin e këtij grupi zgjedhësish.

Amendamentet e futura rishtazi rrisin përgjegjësinë penale për falsifikimin dhe përdorimin e certifikatave të fallsifikuara të lindjes. Dispozita kalimtare parashikon shpalljen të pavlefshme të zgjedhjeve në një njësi zgjedhore, nëse vërtetohet se numri i votave të hedhura duke paraqitur certifikata të fallsifikuara lindjeje mund të ketë ndikuar në shpërndarjen e mandateve.

Në përpjekje për të rritur përgjegjshmërinë dhe transparencën, si dhe duke u përpjekur për përmbytjen e rekomandimeve të mëparshme të OSBE/ODIHR-it, Ministria e Brendshme, përmes DPGjC-së, publikoi më 6 janar një raport “Për procedurat e Ruajtjes, Administrimit dhe Shpërndarjes së Certifikatave të Lindjes dhe Hologrameve të Përdorura për Prodhimin e tyre”. Ky raport jep informacion të hollësishëm rreth shtypjes së certifikatave të reja. Sipas tij, janë prodhuar gjithsej 7,588,999 certifikata. Kryesisht për shkak të skarciteteve, 350,707 certifikata nuk u pranuan pas një kontrolli cilësie të kryer nga teknikët e Ministrisë së Brendshme dhe ato u shkatërruan më vonë nga shtypshkronja që i kishte shtypur ato. Hologramet ishin prodhuar dhe importuar nga Zvicra. Në periudhën shtator–nëntor, në Shqipëri mbërritën 8,300,000 holograme. Ato u ishin ngjitur certifikatave para kontrollit të cilësisë dhe u shkatërruan sipas së njëjtës procedurë. Janë përdorur 8,298,000 holograme. Pjesa e mbetur prej 2,000 hologramesh mbeten nën kujdesin e shtypshkronjës. MVZ-ja do të vazhdojë të ndjekë administrimin e certifikatave të lindjes si në nivel qendror, ashtu edhe vendor.

Me kërkesë të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it, DPGjC-ja prodhoi edhe një raport të hollësishëm sasiar mbi certifikatat e shpërndara NjQV-ve. Sipas këtij raporti, zyrtarët e të gjitha NjQV-ve, përveç atyre të Bashkisë së Tiranës, i morën certifikatat e reja. Drejtori i ZGjC-së së Tiranës tha se ZGjC-ja ishte shumë e zënë për t’i marrë ato, se kishte ende rezerva certifikatash të vjetra, dhe se Bashkia e Tiranës nuk lëshon certifikata lindjeje për qëllime zgjedhore, të cilat lëshohen vetëm nga ZGjC-të e 11 minibashkive.

VII. MEDIA

Konstatimet paraprake të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it për periudhën 13 dhjetor 2006–14 janar 2007 tregojnë se media e shkruar dhe ajo elektronike po bëjnë një mbulim të zgjeruar të çështjeve që lidhen me zgjedhjet. Megjithëse mbulim në media kanë edhe një sërë partish politike, në qendër të vëmendjes janë dy partitë më të mëdha. Në mungesë të kandidatëve të regjistruar, fushata politike në media ka mbetur e kufizuar në edicionet informative të lajmeve dhe reklamat me pagesë për një numër të vogël kandidatësh të emëruar.

Neni 41 i Ligjit për Radion dhe Televizionin Publik dhe Privat e detyron median elektronike “të paraqesë fakte dhe ngjarje në mënyrë të drejtë dhe të paanshme”. Megjithatë, konstatimet paraprake tregojnë se televizioni publik TVSH nuk ka vepruar kështu me edicionet e tij qendrore të lajmeve. Televizioni publik i ka dhënë pothuajse 32 për qind të mbulimit të tij politik PD-së, me një ton tepër neutral ose pozitiv, ndërkohë që PS-ja ka marrë 23 për qind, me një ndarje pak a shumë të barabartë të mbulimit pozitiv dhe negativ. Partitë më të vogla kanë marrë më pak se 5 për qind. Qeveria ka marrë 22 për qind të një mbulimi kryesisht pozitiv.

Televizioni privat Top Channel deri tani ka siguruar një mbulim mjaft të ekuilibruar, duke i dhënë PD-së dhe PS-së, përkatësisht 29 dhe 26 për qind, me një ton tepër pozitiv dhe neutral. Dy televizione private lokale, Vizion + dhe News24, i kanë kushtuar më shumë kohë PS-së, por i kanë pasqyruar që të dyja partitë kryesore në një mënyrë kryesisht neutrale. Kritikkat ndaj PS-së përqendroheshin mbi z. Rama personalisht, në veçanti në News24, ku 37 për qind e portretizimit të tij ka qenë negative.

Dy kanale televizive private me licensë kombëtare, TV Klan-i dhe TV Arbëria, ia kanë kushtuar sasinë më të madhe të informacionit politik Qeverisë (përkatësisht 28 dhe 27 për qind). Megjithatë, mbulimi i partive kryesore nga ana e tyre ka qenë i ndryshëm. Ndërsa TV Klan-i ka bërë kryesisht një mbulim neutral të PD-së, portretizimi nga ana e tij i PS-së ka qenë neutral ose

negativ. Ndryshe nga TV Klan-i, TV Arbëria, u ka dhënë dy partive kryesore një mbulim kryesisht neutral dhe pozitiv. Përveç kësaj, ajo i ka kushtuar 10 për qind të mbulimit LSI-së, me një ton ekskluzivisht neutral ose pozitiv. Kja ka qenë sasia më e madhe kushtuar një ‘partie më të vogël’ në të gjitha organet e monitoruara të medias.

Disa bashkëbisedues nga media të ndryshme i kanë shfaqur MVZ-së pakënaqësi për disa tendera të fundit për licenca televizive, duke thënë se në procedurat e ndjekura nga Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (KKRT-së) mungonte transparenca. Pas publikimit nga disa media të disa informacioneve kritike mbi këtë çështje, KKRT-ja deklaroi se do të ngrinte padi për shpifje kundër tyre, por gjatë periudhës së raportimit nuk ndërmori asnjë hap ligjor. Disa parti opozitare kane kërkuar shkrirjen e KKRT-së dhe caktimin e anëtarëve të rinj, numri i të cileve, sipas marrëveshjes së 30 Gushtit do të rritej me dy anëtarë të propozuar nga shoqëria civile. Në 13 janar Parlamenti vendosi ta rriste numrin e anëtarëve të KKRT-së pa zëvendësuar anëtarët aktuale.

VIII. Aktivitetet e MZV-së të OSBE/ODIHR-it

Gjatë periudhës së raportimit, MZV-ja e OSBE/ODIHR-it vazhdoi aktivitetet e saj pavarësisht se procesi elektoral ishte bllokuar. Kreu i Misionit zhvilloi takime të vazhdueshme me Presidentin, Kryeministrin, Zëvendës Kryeministrin, Kryetaren e Parlamentit, Ministrin e Jashtëm dhe Ministrin e Mbrojtjes, Kryetarin e KQZ-së, drejtues të partive politike dhe zyrtarë të tjerë. MZV-ja vazhdoi gjithashtu takimet me përfaqësues të komunitetit ndërkombëtar dhe bashkëbisedues të tjerë. Një prezantim i dytë për përfaqësuesit e komunitetit ndërkombëtar dhe organizatat ndërkombëtare të akredituara në Republikën e Shqipërisë u mbajt në 5 janar. Vëzhguesit afatgjatë të shpërndare në të gjithë vendin në 11 skuadra me 2 persona secila vazhduan të vëzhgonin situatën parazgjedhore nëpër qarqe.